

Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Bibliotekës Kombëtare M.F. Akhundov të Azerbajxhanit dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

Biblioteka Kombëtare e Azerbajxhanit M.F. Akhundov e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare, në vijim do t'u referohemi si "Palët",

Me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet ekzistuese mes dy bibliotekave dhe në mënyrë që të zhvillohet bashkëpunimi

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e automatizimit të proceseve bibliografike, shkëmbimit elektronik dhe dërgesës së botimeve, restaurimit dhe konservimit të librave të rrallë, si dhe trajnimit të personelit.

Neni 2

Në mënyrë që të shkëmbejnë përvojë dhe dije mbi perspektivat e zhvillimit dhe arritjet në fushat e shkencave bibliotekare dhe informacionit bibliotekar, Palët do të bashkëpunojnë në fushat në vijim:

- automatizimi i proceseve bibliografike bibliotekare;
- përdorim reciprok i katalogut elektronik dhe bibliotekave elektronike;
- menaxhimi i bazave të të dhënave;
- zhvillimi i kërkimit shkencor në fushat e librit dhe botimeve;
- ruajtja, restaurimi dhe konservimi i librave të rrallë;
- zhvillimi i shkëmbimit ndërkombëtarë të librit duke përfshirë edhe shkëmbimin e kopjeve digjitale të librave dhe dorëshkrimeve të rralla në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arkivave të bibliotekave;
- organizim ekspozitash libri;
- shkëmbimi i përvojës mes specialisteve të të gjitha fushave të librit, organizimi i kurseve trajnuese, workshopeve, konferencave shkencore dhe simpoziumeve.

Neni 3

Palët bien dakord që të presin bibliografë nga njëri tjetri për një periudhë maksimumi shtatë (7) ditë.

Akomodimi, vaktet dhe transporti i brëndshëm i bibliografëve do të mbulohet nga vendi pritës, ndërsa shpenzimet e transportit ndërkombëtar do të mbulohen nga vendi dërgues. Numri i bibliografëve do të vendoset në mënyrë të përbashkët çdo vit.

Neni 4

Ky Memorandum është i vlefshëm për një periudhë pesë (5) vjeçare si dhe do të zgjatet automatikisht për pesë (5) vite të ardhshme përveç rasteve kur njëra Palë njofton me shkrim Palën tjetër të paktën tre (3) muaj para përfundimit dhe shpreh dëshirën për ta përfunduar.

Neni 5

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me mirëkuptim të ndërsjellë mes palëve.

Neni 6

Ky Memorandum hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Nënshkruar më *06.10*/2022 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën azere, shqipe dhe angleze, që të gjitha tekstet janë njëloj të vlefshme. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Biblioteka Kombëtare e Azerbajxhanit

M.F Akhundov

Republika e Azerbajxhanit, AZ1000

Baku, Khagani str.,57

Email: contact@anl.az

Tel: + 355 4 222 3843

Fax: + 355 4 222 3843

Drejtor

Prof. Karim Tahirov



Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Sheswhi "Skënderbe"

Tiranë, Albania, 1010

Email: sekretaria@bksh.al

Tel: +994 12 493 40 03

Fax: +994 12 498 08 22

Drejtor

Piro Misha

